# DËSHMI ARKIVI

**A-477601**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nga sheshi mund të krijohet një alternativë e re politike”, Xhemalaj: Presim pjesëmarrje masive të studentëve, protesta vijon deri në dorëheqjen e Ramës |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/nga-sheshi-mund-te-krijohet-nje-alternative-e-re-politike-xhemalaj-presim-pjesemarrje-masive-te-studenteve-protesta-vijon-deri-ne-doreheqjen-e-rames/1031702/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 20:06:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 20:04:11 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3daa1a020010beeeb54da8bf58bf40245389fb50fecab50879b13cd49f664866` |
| TEKSTI | `07845a8afd99e0827f57d41d0ff22ce9d51f2eca8b115ee128bb17967808a225` |
| PAMJA | `88a91d8d7f54406ab9a7c2701e05aa232c43a12c70e7db37f92fb792c9e1a736` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `aff18ee042a72956c38a0aa215c38c7afb43909afb6abae2f8a8eeb5fd5e20a1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6a4afcda2fdbaa1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbef9bbb6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/aff18ee042a72956c38a0aa215c38c7afb43909afb6abae2f8a8eeb5fd5e20a1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Nga sheshi mund të krijohet një alternativë e re politike”, Xhemalaj: Presim pjesëmarrje masive të studentëve, protesta vijon deri në dorëheqjen e Ramës




Aktivisti Ilir Xhemalaj deklaroi se zgjerimi i pjesëmarrjes së studentëve dhe të rinjve mbetet një nga objektivat kryesorë të protestës.

Gjatë një interviste në studion e News24 me gazetaren Daljana Sejdia, ai shpjegoi se marshimi i së hënës drejt Qytetit Studenti u zhvillua pikërisht për t’iu drejtuar të rinjve dhe për t’i nxitur ata që ta shprehin energjinë e tyre përmes protestës.

“Pritshmëria jonë është që studentët të përfshihen fuqishëm në protestë. Tubimi i sotëm ishte në funksion të tyre, ndaj marshuam drejt Qytetit Studenti. Kjo lëvizje nisi nga të rinjtë dhe synojmë që energjia e tyre të përqendrohet në shesh deri në rrëzimin e Ramës”, u shpreh Xhemalaj.

Ai kritikoi gjithashtu opozitën dhe Sali Berishën, duke theksuar se protesta nuk duhet të përcaktohet nga përkatësitë politike. Sipas tij, çdo person që kërkon largimin e kryeministrit duhet të jetë pjesë e tubimeve.

“Bëhet fjalë për një sistem 80-vjeçar. Përballë kemi Ramën dhe Berishën, i cili deri tani ka qëndruar jashtë sheshit. Nëse synojnë rrëzimin e Ramës, të dyja palët duhet të jenë në shesh. Në ditët e para pamë aty shumë punonjës të administratës, socialistë dhe demokratë. Qeveria ka mundur t’i shantazhojë, ndaj sot u kemi bërë thirrje të gjithëve të bashkohen me ne. Të rinjtë duhet të dalin në shesh, pasi nuk kanë më çfarë të presin”, tha ai.

Xhemalaj vlerësoi se protesta, pas 121 ditësh, ka kaluar në një fazë më të pjekur. Ai shtoi se grupet dhe individët që janë përfshirë në të tashmë kanë kapacitetin për të ndërtuar një organizim më të strukturuar.

“Që nga dita e parë kanë ndodhur shumë ndryshime. Protesta është pjekur, ndërsa grupimet dhe figurat e

të fundit/


Ran Ben Shimon mbetet në detyrë, Izraeli shpreson te…


Flokët e gjata të Scipios nxorën me karton të kuq dy lojtarë…


Nga “vajza më e shëmtuar e shkollës” te një prej modeleve më…


Haxhiu: Bashkëpunimi me PDK-në po, koalicioni qeverisës jo


Prishtina për të 13-ën natë radhazi në mbështetje të ish-…


Haxhiu: Tensionet politike më shtynë të prisja para thirrjes së…


Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

angazhuara kanë kapërcyer fazën fillestare. Tani ekziston pjekuria dhe vullneti për të vijuar me një organizim të ri. Prej kësaj mund të lindin grupet politike të së ardhmes", deklaroi aktivisti.

Sipas tij, lëvizja duhet të shërbejë si bazë për krijimin e një alternative politike. Xhemalaj e konsideroi të vështirë një largim vullnetar të Ramës nga posti.

"Duke parë gjendjen e opozitës, ndërsa diktatori është shndërruar në një kafshë të plagosur dhe për këtë arsye është më i rrezikshëm se kurrë, nevojitet një alternativë. Nuk besoj se Rama do të japë dorëheqjen, sepse një diktator nuk largohet kurrë vetë nga pushteti", u shpreh ai.

Megjithatë, aktivisti nënvizoi se rotacioni politik duhet të realizohet përmes zgjedhjeve dhe jo nëpërmjet marrjes së pushtetit në forma të tjera.

"Nga protesta duhet të krijohet një lëvizje politike dhe më pas duhet të shkohet në zgjedhje. Pushteti merret vetëm përmes zgjedhjeve, jo nga sheshi apo nga ndonjë rrugë tjetër", përfundoi Xhemalaj.

Shtuar më 28.09.2026 22:04

Tags: -Politikë , kryesorë , Lajmet e fundit , Shqiperia , Të Gjitha



Dita e 121 e protestës në Tiranë, qytetarët marshojnë drejt "Qytet Studenti":…



Flakët përfshijnë barishte e kallamishte në Bishan të Vlorës, era vështirëson…



Brukseli përgatit një udhërrëfyes të posaçëm për Shqipërinë dhe tre…



Në ditën e 121 të protestës, marshim drejt Kryeministrisë me thirrje…



Shehaj në takimin ndërparlamentar me BE-në: Rama po zhvillon një sul…



Stresi merr vendimin, largohet nga rrjetet sociale, ja çfarë njoftoi reperi



Zjarr i përmasave të mëdha në kodrën pranë Mëmlishtit, flakët kërcënojnë pyllin m…



Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një grua dhe i mori paratë, policia kërk…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.